



BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJSH MUAJI PRILL




PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Kuriozitete për muajin PRILL

Çfarë duhet të dimë për muajin Prill?



- * Muaji Prill është muaji i dytë i stinës së pranverës.
- * Prilli është muaji i luleve, i ngjyrës së gjelbërt dhe i poezisë.
- * Muaji Prill shënon Ditën Ndërkombëtare të Zogjve.
- * Muaji Prill është muaji i ndërgjegjësimit për librin.
- * Në muajin Prill është Dita e Balonave.



Muaji Prill- Tema: Qyteti dhe fshati

Grupi: 24-36 muajsh

- * **Java I:** Elementët e qytetit
- * **Java II:** Elementët kryesorë të fshatit
- * **Java III:** Njohja me mjetet e transportit
- * **Java IV:** Respektojmë rregullat në komunitet

Tema mujore: Qyteti dhe fshati		
Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Njohja me elementët kryesorë të qytetit	Njohja me elementët kryesorë të qytetit si: lagjet, pallatet, rrugët, parqet.	Java I
Njohja me elementët kryesorë të fshatit	Njohja me disa elementë kryesore si: fusha, livadhi, mali, pylli, ferma, etj.	Java II
Njohja me mjetet e transportit	Mësojmë mjetet e transportit.	Java III
Respektojmë rregullat në komunitet	Njohja me rregullat e komunitetit ku banojmë. Njohja me rregullat në çerdhe.	Java IV


Shënim:





- * Stafii edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim përvetësimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
- * Stafii edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.





Tema mujore: Qyteti dhe fshati

Tema e javës: Njohja me qytetin







Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Njohim qytetin tonë 	<ol style="list-style-type: none">1. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për qytetin. Ajo demonstroi pamje nga qyteti; rrugët, lulishtet/parqet, këndet e lojërave, pallatet, shkollat, kopshtet. Edukatorja pyet fëmijët nëse ata shkojnë të luajnë tek këndet e lojërave apo nëse shëtisin në parqe, lulishte?2. Lojë: “Treni në tunel” Disa fëmijë kapen për dore duke krijuar tunelin dhe fëmijët e tjerë futen në tunel duke imituar trenin me tinguj.3. Vjersha: “Ora e qytetit”4. Punë dore: “Qyteti me drita”	Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë të bardha/fletë me ngjyra
E Martë	Njohja me disa nga elementët e qytetit	<ol style="list-style-type: none">1. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për vende në qytet ku fëmijët kalojnë kohën e lirë me familjen, gjyshërit, si: Parku i Liqenit, Sheshi “Skënderbej”, këndet e lojërave, etj.2. Punë dore: Sahati i Tiranës me karton, fara, fasule, oriz etj.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: libra, karton, fara etj

		<p>3. Vjersha: “Ora e qytetit”.</p> <p>4. Lojë: Fëmijët krijojnë një rreth në formën e orës dhe pasojnë topin tek njëri –tjetri në drejtimin e lëvizjes së akrepave të orës</p> <p>5. Aktivitet: Edukatorja u flet fëmijëve për rëndësinë e librit. Ajo së bashku me fëmijët vendosen në këndin e librave dhe lexon një përrallë sipas dëshirës së fëmijëve.</p>	
<p>E Mërkurë</p>	<p>Njohja e objekteve historike të qytetit.</p> 	<p>1. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për Tiranën, për objektet kryesore historike të saj (Kulla e Sahatit, Ura e Tabakëve, Mozaiku i Tiranës). Ajo i pyet fëmijët nëse i kanë vizituar këto vende.</p> <p>2. Vjersha: “Ora e qytetit”.</p> <p>3. Krijim: Ndërtimi me kuba i një objekti: pallat/shtëpi/çerdhe etj. Mësojmë të numërojmë duke ndërtuar. (Shiko modelin)</p> <p>4. Lojë: Lojëra energjike në natyrë</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Kuba.</p> 



<p>E Enjte</p>	<p>Njohja me kafshët shtëpiake</p> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vjersha: “Shtëpia e bubit”. 2. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja flet për kafshët shtëpiake si: macja, qeni (që rriten në apartamente dhe shtëpi). Ajo pyet fëmijët nëse ata kanë kafshë shtëpiake?/Si quhen ato?/A kujdesen për to? 3. Kënga: “Macja le të lahet”. 4. Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin kafshë shtëpiake: një qen/mace. 5. Loja e ekuilibrit: Fëmijët vendosen dyshe–dyshe përballë njëri-tjetrit dhe duke ndjekur drejtimin e një litari/spangoje të vendosur në tokë, përpiqen të mbajnë me kokë topin/tollumbacin ose të transportojnë një send/lodër duke ruajtur ekuilibrin. 	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: letra, lapsa me ngjyra</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Krijimi i zogjve me punë dore</p> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vjersha: “Qukapiku”. 2. Krijim: “Varëse me makarona”. Edukatorja ndihmon fëmijët të fusin makaronat (e ngjyrosura më parë) në fill duke krijuar varësen me makarona. (Edukatoret mund të përdorin modelin në foto) 3. Punë dore: Krijimi i zogjve. Edukatoret mund të përdorin fara të ndryshme, pjata plastike, plastelinë etj 4. Përralla: “Mbreti i fluturimeve”. 	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: letra, pjata plastike,ngjitës, letra me ngjyra/ose fara të ndryshme. Makarona,fill.</p> 

Tema e javës: Njohja me fshatin




Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Njohja e elementëve kryesorë të fshatit.</p> 	<ol style="list-style-type: none"> Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja u tregon fëmijëve pamje nga fshati, si livadhet, fushat, fermat, shkollat, shtëpitë./Pyet fëmijët se cili, cila prej tyre ka gjyshër/të afërm në fshat./Iu flet fëmijëve për të mirat e fshatit, për prodhimet buqësore (perimet, frutat) dhe blegtorale (qumështi, gjalpi, djathi, etj) që marrim nga fshati dhe për ajrin e pastër. Bisedë edukatore-fëmijë: flasim për malin dhe fushën: mali është i lartë dhe i madh; fusha është e sheshtë. Edukatorja pyet fëmijët: Si është fusha? Si është mali? A keni shkuar në fushë/mal? Përralla: “Fuqia e këngës”. Lojë sensoriale: Krijojmë fushën me oriz të ngjyrosur (ngjyrë e gjelbërt) Fëmijët prekin dhe luajnë me orizin e ngjyrosur. 	<p>Mjete Didaktike: libra, lapsa me ngjyra, karton A3,oriz,bojë. Libri “365 rrëfenja para gjumit”</p>
E Martë	<p>Njohja e objekteve historike të fshatit</p> 	<ol style="list-style-type: none"> Bisedë: Edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se edhe fshati, ashtu si qyteti, ka shumë objekte historike. Në fshatrat e Tiranës, 2 nga objektet historike janë: Kalaja e Prezës dhe Kalaja e Petrelës, vende të bukura për të kaluar një fundjavë me prindërit në ajrin e pastër. Edukatorja pyet fëmijët: Kush nga ju i ka vizituar këto vende apo të tjera? Vjersha: “Kafshët në fermë”. Punë dore: Kalaja me mjete të riciklueshme si karton, letra etj. Përralla: “Çfarë cirku”. 	<p>Mjete Didaktike Manuali i Vjershave Libri “365 rrëfenja para gjumit”</p> 

<p>E Mërkurë</p>	<p>Njohja me kafshët që jetojnë në fshat</p> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vjersha: “Kafshët në fermë”. 2. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve mbi kafshët e fermave të fshatit (lopa, delja, dhia, derri, kali, gomari, etj) dhe të mirat që marrim prej tyre, si qumështi, djathi, gjalpi, mishi dhe lëkura, leshi për këpucë dhe veshje. 3. Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. 4. Aktivitet: Krijimi i fermës dhe i kafshëve të fermës me karton dhe shkopinj. 	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: karton A3, lapsa me ngjyra,shkopinj.</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Njohja me shpendët që jetojnë në fshat</p> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve mbi shpendët e fshatit (pula, gjeli, rosa) dhe të mirat që marrim prej tyre si, vezët, mishi. 2. Loja: Pula dhe dhelpira. Loja zhvillohet në oborr. 3. Vjersha: “Rosat në liqen”. 4. Punë dore: Rosa po lahet në liqen, me pjata plastike 5. Përrallë: Dhelpira dhe lejteku. 	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: pjatë plastike, karton,bojë.</p>




<p>E Premte</p>	<p>Krijimi i kafshëve me punë dore</p> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vjersha: “Kafshët në fermë”. 2. Punë dore: Krijimi i kafshëve të fermës. 3. Loja: “Kafshët në fermë”. Kafshët e krijuara me punë dore vendosen mbi njëra-tjetrën për të formuar një piramidë. Pastaj fëmijët fillojnë t'i rrëzojnë me top. Kush kafshë rrëzohet emërtohet nga fëmija dhe imitohet tingulli. 4. Kënga: “Bubrrrec”, kënga shoqërohet me lëvizje të trupit. Udhëheq edukatorja. 	<p>Manuali i Vjershave Mjetet Didaktike: karton, ngjitës, top.</p> 
------------------------	--	--	--


Tema mujore: Qyteti dhe fshati
Tema e javës: Mjetet e transportit







Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Njohja me mjetet e transportit</p>	<p>1. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se njerëzit shpikën mjetet e transportit, për të udhëtuar, për të çuar mjete dhe sende nga një vend në tjetrin, për të komunikuar (posta çon letra me makinën e saj), për të ndihmuar njerëzit (makina e urgjencës), etj. Mjetet e transportit janë të shumëllojshme duke filluar nga karroca me kuaj deri tek raketat: biçikleta, makina, autobusi, kamioni, treni, aeroplani, anija. Edukatorja pyet fëmijët: keni udhëtuar me makinë, me autobuz? Edukatorja iu</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: kartona, pjata plastike, ngjitës.</p> 

		<p>përmend profesionet e shoferit, makinistit të trenit, pilotit, timonierit të anijes.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr. 3. Kënga: “Gabimi i Mirelës”. 4. Punë dore: Makina me karton. Fëmijët luajnë me makinën e krijuar 	
<p>E Martë</p>	<p>Njohja e mjeteve të transportit nëpërmjet ngjyrosjes</p> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kënga: “Autobusi”. 2. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve mjetet e transportit që na ndihmojnë në situata rreziku: zjarrfikëse, ambulancë, makinat e policisë, që janë të shpejta dhe të pajisura me mjete shpëtimi. 3. Vizatimi: Ngjyrosja e figurave të përgatitura më parë nga edukatorët. (sugjerohet përdorimi i figurave gjeometrike për modelimin). 4. Krijim: Krijojmë një park automjetesh. 5. Lojë: Fëmijët mësojnë të numërojnë duke parkuar makinat. Edukatorja i kërkon fëmijës të parkojë makinën psh. në vendparkimin me numër 3. (Në vëndet e parkimit vendosen numra nga 1 deri në 5. 	<p>Mjete Didaktike: letër,lapsa,karton, makina.</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Mjetet e transportit Tokësor</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vjersha: “Treni”. 2. Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se mjetet e transportit tokësor janë mjetet që ecin në tokë si: makina, autobusi, treni, bicikleta, karroca, etj. Edukatorja u shpjegon fëmijëve se kur jemi në makinë është e rëndësishme të jemi të ulur tek stoli për fëmijë dhe të jemi gjithmonë të lidhur me rripin e sigurimit. 3. Kënga: “Autobusi”. 4. Loja: luajmë me biçikleta në oborr 	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Biçikleta</p> 

			
E Enjte	Mjetet e transportit ajror dhe uJOR 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Bisedë edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve për mjetet e transportit ajror si: aeroplani, helikopteri, balona, parashuta dhe raketat. Fëmijët emërtojnë mjetet e transportit së bashku me edukatoren. 2. Punë dore: Ndërtimi i një balone. Edukatorja ndihmon të ngrenë balonën në oborr. 3. Bisedë: edukatore-fëmijë. Edukatorja përmend mjetet e transportit uJOR: varka, anija, nëndetësja dhe fton fëmijët t'i emërtojnë këto mjete. 4. Vjersha: “Si marinar”. 	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: letër,shkpinj,fill. 
E Premte	Krijojmë një aeroplan dhe një varkë me punë dore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vjersha: “Treni”. 2. Lojë energjike: me shami, me top. Lojërat zhvillohen në oborr. 3. Punë dore: “Aeroplani me shishe” 4. Kënga: “Autobusi”. 5. Punë dore: “Varka”. Fëmijët ndërtojnë një varkë prej letre. 	Manuali i Vjershave Manuali i lojrave Mjete Didaktike: letër,shishe plastike.



Tema mujore: Qyteti dhe fshati
Tema e javës: Respektojmë rregullat në komunitetit

Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Rregullat e sjelljes ne çerdhe</p>  	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rëndësinë e rregullave kur qëndrojnë së bashku në çerdhe. Disa nga rregullat që fëmijët duhet të dinë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të luajmë së bashku. -Të ndajmë lodrat me njëri-tjetrin. -Të mos shtyjmë shokun/ shogën. -Të hamë të gjithë bashkë dhe të zbatojmë rregullat e të ngrënit. -Të mbajmë pastër veten (të lajmë duart, të lajmë dhëmbët). -Të mbajmë pastër ambjentin (të mos hedhim mbeturina në tokë, të mos derdhim ushqimin) dhe t'i hedhim mbeturinat në koshin e mbeturinave. <p>Aktivitet në natyrë: Fëmijët dalin në oborr dhe bashkë me edukatoren mbledhin mbeturinat, gjethet e pemëve, gurët dhe i hedhin në koshin e plehrave/mbeturinave.</p> <p>Lojë e lirë energjike: me top. Loja zhvillohet në oborr.</p> <p>Vjersha: “Duart tona”.</p> <p>Përralla: “Mësime kopshtarie”.</p> <p>Ngjyrosje/vizatim e lirë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.105)</p>  

<p>E Martë</p>	<p>Ecim në vijat e bardha.</p> <p>Semafori.</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja flet për vijat e bardha dhe rregullat e qarkullimit.</p> <p>Vjersha: “Semafori”.</p> <p>Krijim: Krijimi i semaforit, vendosja e vijave të bardha (nëpërmjet fletëve të formatit, karton i bardhë).</p> <p>Aktivitet: Improvizimi i një situatë në semafor (një fëmijë vishet si polic/e, një tjetër si qytetar/e).</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin dritat e semaforit në modele të përgatitura më parë nga edukatorët.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: letër, karton.</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Të duam, të respektojmë natyrën.</p>  <p>Krijojmë peshkun me plastelinë.</p>	<p>Vjersha: “Mos e këput lulen”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se duhet ta duam dhe të kujdesemi për natyrën. Ajo iu kujton fëmijëve se lulet nuk këputen, mbeturinat nuk i hedhim në det/liqen. Lulet, pemët zbukurojnë ambientin dhe pastrojnë ajrin. Edukatorja pyet fëmijët: Kush ka lule në shtëpi? Kush kujdeset për to?</p> <p>Aktivitet në natyrë: Edukatorja së bashku me fëmijët ujin një lule në oborrin e çerdhës.</p> <p>Vjersha: “Duart tona”.</p> <p>Punë dore me plastelinë: Krijimi i peshkut me luspa me ngjyra (edukatorët të përdorin modelin e këtij materiali për të ndërtuar peshkun duke përdorur plastelinë dhe kopsa për luspat).</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: plastelinë, kopsa.</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Fjalët magjike</p>	<p>Lojë e lirë energjike: me shami, me top. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për fjalët magjike dhe rëndësinë e tyre në ambientin ku ne jetojmë. Ajo pyet fëmijët se cili/cila prej tyre mund të thotë një fjalë magjike.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i lojrave. Mjete Didaktike Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.56)</p>

		<p>Aktivitet: Inskenimi i situatave të ndryshme kur themi “Mirëmëngjes” “Faleminderit”, “Të lutem”, “Më fal”, etj.</p> <p>Kënga: “Fjalët magjike”.</p> <p>Përralla “Rrepkat e lezetshme”.</p>	
<p>E Premte</p>	<p>Krijimi i luleve.</p>	<p>Kënga: “Fjalët magjike”.</p> <p>Lojë e lirë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Vjersha: “Mos e këput lulen”.</p> <p>Punë dore: “Krijimi i luleve të ndryshme me letër, shkopinj, plastelinë etj</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa shkopinj, letër A4, plastelinë.</p>